

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – Kž – 251/2010

12 tetor 2010

Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegit dhe nga anëtarët e kolegit Norbert Koster dhe Lars Dahlstedt, gjyqtarë të EULEX-it si dhe Salih Toplica dhe Gyltene Sylejmani, gjyqtarë të Gjykatës supreme, të asistuar nga Zyrtari ligjor Sampsa Hakala, në cilësinë e procesmbajtësit.

Në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] H. [REDACTED] i [REDACTED] me adresa të fundit në Fabatin Beqarë e Llazit nr. 145, [REDACTED], i akuzuar për veprën penale **Vrasje e rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, pikat 4, 5 dhe 9 të Kodit të Përkoħshem Penal të Kosovës (KPPK) dhe për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, par. 1 të KPPK-së.

Duke vodosur lidhur me ankesën e të pandehurit të paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës I. [REDACTED] K. [REDACTED] më 15 korrik 2010 kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit pér lëndën KP Nr. 145/2007, të datës 13 mars 2008, përmes së cilit Gjykata e Qarkut të Prizrenit kishte shpallur të pandehurin fajtor pér veprat penale e ngarkuara dhe kishte dënuar të njëtin me 18 vjet burgim pér pikën 1 dhe me pagesë të gjobës prej 5,000 eurosh pér pikën 2.

Pas marjes së përgjigjes nga Prokurori i qarkut të paraqitur më 2 gusht 2010 dhe të mendimit dhe propozimit të Prokurorit të shtetit të Kosovës, të paraqitur më 19 gusht 2010,

Në seancë të hapur pér publikun, më 12 tetor 2010, pas këshillimit dhe votimit lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e të pandehurit S████ H████ e paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës I████ K████ kundër Aktgjykimit KP Nr. 145/2007 të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, të datës 13 mars 2008, PRANOHET PJESËRISHT.

Aktgjykimi KP Nr. 145/2007 i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, i datës 13 mars 2008 NDRYSHOHET në pjesën e dënimit:

1. Për veprën penale Vrasje e rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, pikat 4, 5 dhe 9 të KPPK-së, S████ H████ dënohet me një dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) vjetësh.
2. Për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 1 të KPPK-së, S████ H████ dënohet me pagesën e gjobës prej 2,500 eurosh.
3. Në përputhje me Nenin 73 të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim që nga dita e arrestimit të tij më 4 korrik 2006 do t'i llogaritet S████ H████ në dënimin e shqiptuar me burgim prej 18 vjetësh.
4. Gjoba prej 2,500 eurosh duhet të paguhet brenda 120 ditësh nga dita kur Aktgjykimi bëhet i formës së prerë. Mospagimi i kësaj gjobe brenda afatit ligjor do të rezultojë në pagesën e detyruar të gjobës.

ARSYETIM

I Historia procedurale

Më 4 korrik 2006, rrëth orës 11:00 në qytetin e Prizrenit është vrarë G████ D████. I pandehurit S████ H████ është arrestuar pak kohë pas qitjes nga arma e zjarrit – pistoleta Zastava .357 Magnum, e cila është konfiskuar nga policia.

Më 7 korrik 2006 ka nisur hetimi penal kundër S████ H████ dhe Prokurori publik ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit ka paraqitur aktakuzën kundër S████ H████ të datës 27 qershor 2007 për veprat penale Vrasje e rëndë, në kundërshtim me

Nenin 147, pikat 4, 5 dhe 9 të KPPK-së, Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me Nenin 291 (3) të KPPK-së si dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328 (2) të KPPK-së.

Më 29 gusht 2007, është konfirmuar aktakuza për pikat 1 dhe 3 të veprave penale Vrasje e rëndë dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ndërsa pika tjetër është hedhur poshtë.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 25 tetor 2007 në praninë e Prokurorit publik, të pandehurit dhe të avokatit të tij mbrojtës dhe të përfaqësuesit të palëve të dëmtuara. Me kërkesë të avokatit mbrojtës është urdhëruar vlerësimi i aftësisë së të pandehurit dhe shqyrtimi gjyqësor është shtyrë duke pritur rezultatin e vlerësimit të kryer nga ekspertët përkatës.

Më 28 shkurt 2008, Gjykata e Qarkut të Prizrenit ka lëshuar një aktvendim të ndarë përkitazi me aftësinë mendore të pandehurit S. H. Gjykata ka konstatuar se Shpend Hoti nuk ka qenë i paaftë në aspektin mendor në kohën e kryerjes së krimtit dhe nuk ka vuajtur nga kapaciteti i zvogëluar mendor. Sipas këtij aktvendimi, H. nuk ka vuajtur nga ndonjë sëmundje mendore apo çrregullim mendor apo çrregullim në zhvillimin mendor i cili ka ndikuar në funksionimin e mendjes së tij në atë masë sa që ta paaftësojë për t'i kuptuar ose kontrolluar veprimet e veta apo për ta kuptuar se po kryente një vepër penale. Kundër këtij aktvendimi nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar më 13 mars 2008 në praninë e Prokurorit publik, të pandehurit dhe të avokatit të tij mbrojtës si dhe të përfaqësuesit të palëve të dëmtuara. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri është deklaruar fajtor për dy pika. Në fund të shqyrtimit është nxjerrë aktgjykimi me të cilin S. H. është shpallur fajtor për Vrasje të rëndë dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, dhe iu ka shqiptuar dënimini prej 18 vjetësh burgim së bashku me gjobën në vlerë prej 5,000 eurosh.

S. H. është urdhëruar të mbahet në paraburgim derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Sipas dokumentacionit të shkresave të lëndës, Aktgjykimi i shkallës së parë i është dorëzuar personalisht të pandehurit S. H. në burgun e Dubravës më 12 korrik 2010.

Avokati mbrojtës I. K. ka paraqitur ankesë kundër këtij aktgjykimi më datën 15 korrik 2010.

Përgjigja e Prokurorisë së Qarkut është paraqitur më 2 gusht 2010, ndërsa mendimi i Prokurorisë së Shtetit është pranuar më 19 gusht 2010.

II Ankesa dhe përgjigjja e Prokurorit publik

Ankesa e avokatit I. K., e paraqitur më 15 korrik 2010, kundërshton Aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me vendimin mbi dënimin. Avokati mbrojtës propozon ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë duke ia caktuar të pandehurit një dënim më të butë për të dyja veprat penale.

Sipas kësaj ankesë, Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh si duhet rrethanat lehtësuese si në vijim:

- Moshën relativisht të re të të pandehurit S. H. në kohën kur i ka kryer veprat penale.
- Faktin që S. H. është deklaruar fajtor dhe ka shprehur pendimin e vet të thellë për veprimet e kryera.
- Faktin që H. ka vuajtur nga çrregullimi psikik i ashtuquajtur “Çrregullim antisocial i personalitetit” siç tregohet me raportet mjekësore.

Në seancën e Gjykatës Supreme të mbajtur më 12 tetor 2010, Avokati mbrojtës është deklaruar edhe mbi rrethanat personale të të pandehurit. Në veçanti, Avokati mbrojtës iu është referuar disa ngjarjeve që lidhen me marrëdhëniet familjare në familjen e S. H. të cilat kanë ndodhur gjatë kohës së qëndrimit të tij në paraburgim.

Kryeprokurori i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit në përgjigjen e tij deklaron që kjo ankesë është e pabazë dhe si e tillë duhet patjetër të refuzohet. Prokuroria mbetet pranë qëndrimit të saj se Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka vlerësuar të gjitha rrethanat përfshirë këtu edhe ato lehtësuese. Prokurori deklaron se dënimini i shqiptuar është proporcional me veprat e kryera, me rrezikun e lartë dhe me pasojat e veprave, me sjelljen e të pandehurit dhe me rrethanat e tjera.

Prokurori i Shteti në mendimin e tij inkurajon Gjykatën Supreme të Kosovës që ta refuzojë ankesën dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Prokurori i shtetit konsideron se ekzistojnë tri rrëhana lehtësuese në këtë rast siç edhe është propozuar edhe në ankesë. Megjithatë, Prokurori i shtetit konstaton se për shkak të seriozitetit të veprave penale, dënim i shqiptuar nuk bën që të zvogëlohet.

III Gjetjet e gjykatës

Ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit S. [REDACTED] H. [REDACTED] është paraqitur me kohë dhe është pranueshme.

Sic është thënë edhe më herët, S. [REDACTED] H. [REDACTED] është deklaruar fajtor për të dyja akuzat. Pranimi i tij i fajtit është pranuar nga Gjykata e shkallës së parë dhe çështja e fajësisë si e tillë nuk është kundërshtuar me ankesën e avokatit mbrojtës. Çështjet e ngritura në ankesë lidhen vetëm me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë. Prandaj, lartësia e dënitimit të të pandehurit do të shqyrtohet.

Gjatë përcaktimit të dënitimit, qëllimi i dënitimit dhe të gjitha rrëthanat të cilat janë të rëndësishme për uljen apo rritjen e dënitimit duhet patjetër të merren parasysh¹. Dëni duhet të jetë brenda kufijve të përcaktuar me ligj për vepra të tilla penale, proporcional me seriozitetin e veprës dhe me sjelljen dhe me rrëthanat e të pandehurit.

Sa i përket dënitimit të shqiptuar për veprën penale Vrasje e rëndë, ankesa është e pabazë. Kufijtë e përcaktuar me ligj për këtë lloj të veprës penale janë burgim prej së paku 10 vjetësh ose dënim me burgim afatgjatë. Afati i burgimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë është i qëlluar duke marrë parasysh rrëthanat përkatëse të cilat lidhen me veprën penale dhe me të pandehurin.

Rrëthanat e padiskutueshme që lidhen me vrasjen e G. [REDACTED] D. [REDACTED] kërkojnë një dënim të ashpër. Në bazë të faktave të pakundërshtueshme të kësaj lënde, S. [REDACTED] H. [REDACTED] duke vepruar pa asnjë paralajmërim ose provokim dhe në shenjë të hakmarjes së paskrupullt ia mori jetën G. [REDACTED] duke e qëlluar nga një distancë shumë e vogël, në mënyrë mizore dhe të dhunshme, me gjashtë të shtëna nga revolveri Magnum i kalibrit .357 në

¹ Shih Nenin 64 të KPPK-së mbi Rregullat e përgjithshme për matjen e dënitimit.

shpinë G. D. i cili ishte ulur në një tavolinë përpara ëmbëltores në sheshin Shadervan pranë qendrës së Prizrenit.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, sjellja e S. H. ka vënë në rrezik qëllimiشت jetën e së paku tre personave të tjerë të cilët ishin të ulur pranë S. H. në kohën e të shtënavë.

Vepra penale e kryer nga S. H. përbush tre nga gjithsej dymbëdhjetë kushtet ligjore të Vrasjes së rëndë edhe pse cilado nga këto rrethana rënduese do ta cilësonë veprën penale si Vrasje të rëndë: gjatë vrasjes së G. D. S. H. qëllimiشت ka rrezikuar jetën e më shumë se një personi sipas pikës 4 të Nenit 147 të KPPK-së. S. H. e privoi nga jeta G. D. duke vepruar në mënyrë mizore dhe të dhunshme, sipas pikës 5 të Nenit 147 të KPPK-së dhe S. H. e privoi nga jeta G. D. për shkak të hakmarrjes së paskrupullt ose për shkak të ndonjë motivi tjetër të ulët, sipas pikës 9 të Nenit 147 të KPPK-së.

Pasojat ekstreme të veprës penale si dhe mënyra mizore dhe e vendosur në të cilën është kryer vepra penale nga ana e të pandehurit nënvizojnë seriozitetin e veprës, duke detyruar një dënim afatgjatë.

Sa i përket sjelljes dhe rrethanave personale të të pandehurit, Gjykata Supreme qëndron prapa konstatimit të tyre se ekzistojnë disa nga rrethanat lehtësuese që lidhen me moshën e re të S. H. dhe me pranimin e fajit. Për më tepër, është treguar me dëshmi mjekësore se S. H. në kohën e kryerjes së veprës penale ka vuajtur nga çrrëgullimi antisocial i personalitetit. Megjithëkëtë, të gjitha këto janë konstatuar në mënyrë të drejtë dhe gjithashtu janë marrë parasysh nga Gjykata e shkallës së parë lidhur me dënimin.

Lidhur me akuzën që ka të bëjë me Mbajtjen e paautorizuar në pronësi të armës së zjarrit, Gjykata konsideron se gjoba në lartësi prej 2,500 eurosh është dënim adëkuat. Disa ditë para vrasjes së G. D., më 26 qershor 2006, S. H. ishte arrestuar nga policia për mbajtje të kundërligjshme të një arme tjetër, revole Beretta 7.65 mm dhe e kishte dënuar të njëtin me pagesën e gjobës prej 1,000 eurosh për këtë vepër penale. Për këtë arsy, dëni është caktuar që të jetë më shumë sesa 1,000 euro pasi që kjo vepër penale është përsëritur nga i pandehuri.

Për këto arsy, është vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

**Sot më 12 tetor 2010.
Ap.-Kž. Nr. 251/2010**

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar.

Kryetari i kolegjit

Martti Harsia

Anëtari i kolegjit

Norbert Koster

Anëtari i kolegjit

Lars Dahlstedt

Anëtari i kolegjit

Salih Toplica

Anëtarja e kolegjit

Gyltene Sylejmani

Procesmbajtësi

Sampsia Hakala